

KONTRATE UDHETIMI, Pakete turistike

Kjo kontrate lidhet midis paleve ne daten

Operatori Turistik qe ofron kete udhetim turistik:

MTI TRAVEL ,Organizatori (Me numer License: LN-2886-03-2017).

Klienti qe blen kete udhetim turistik

Vlera e kontrates eshte:

Pagesat: Ne momentin e konfirmimit dhe firmosjes se kontrates nje paradhenie 50% te shumes se kontrates.

Pjesa tjetere e pageses duhe mbylluar maksimumi deri ne 20 dite perpara nisjes.

Ne raste specifike Klienti duhet ta mbylle 100% pagesen, 30 Dite perpara nisjes, dhe ky fakt do ti behet me dije klientit ne momentin e firmosjes se kontrates.

Ne rast se klienti nuk respekton afatet e pagesave, organizatorit i lind e drejta te anulloje rezervimin dhe te mbaje kostot qe shkaktohen nga ky anulim.

Anullimet nga Klienti pas firmosjes se kontrates:

a- Kjo kontrate ka nje kosto te pakthyeshme prej: 50 % e vleres se kontrates kur anulimi kryhet deri ne 30 dite kalendarike para nisjes.

b- Kjo kontrate ka nje kosto te pakthyeshme prej: 80 % e vleres se kontrates kur anulimi kryhet 29 deri ne 15 dite kalendarike para nisjes.

c- Kjo kontrate ka nje kosto te pakthyeshme prej: 100 % e vleres se kontrates kur anulimi kryhet 14 deri ne 0 dite kalendarike para nisjes.

Ne rastin "a" kur klienti anulon udhëtimin me shume se 30 dite perpara nisjes, ai (Klienti) duhet ti paguaje Organizatorit te gjitha kostot direkte te kryera per Klientin deri ne momentin e anulimit (ne se ka), te cilat mund te jene:

Kostot e Kompanise ajrore (ne se ka), Hotelit (ne se ka),, Autobusit (ne se ka),, Biletet se Hyrjeve ne Monumente (ne se ka),, restorante apo guide (ne se ka),, te cilat mund te jene nga 0-100% te pageses. Kostot i behen te ditura klientit ne momentin qe ai vendos per anulim, duke perfshire dhe kostot e transfertave bankare. ..

Anullimi i Udhëtimit: Klienti rezulton Pozitiv perpara Nisjes.

Bileta e avionit: Mund te zevendesohet me nje date te re, ose mund te rimbursohet nje pjese e pageses, ne varesi te politikave te kompanise ajrore.

Hoteli i rezervuar: Rezervimi Mund te zevendesohet me nje date tjetere.

Guida dhe transporti ne Destinacion jane te Parimbursueshme, dhe do ti paraqiten klientit me ane te faturave te paguara.

Anullimi i Udhëtimit: COVID – 19. Qeveria ne destinacionin perkates Bllokon udhëtimet turistike.

Ne kete rast do ti kerkohet elementeve perberes te paketes turistike per te zevendesuar udhëtimin ne nje date te re: Kompanise Ajrore, Hotelit, Kompanise transportuese ne destinacion, Guidave Lokale.

Anullimi nga ana e klientit pa penalitet

Klienti mund të tërhiqet nga Kontrata, pa paguar penalitete në rastet qe vijojne:

Rritja e cmimit nga organizatori me shume se 10%.

Ndryshime të rëndësishme të një ose disa elementeve të kontratës, të cilat cilësohen thelbësore për realizimin e plotë të paketave turistike por para nisjes, të papranuara nga klienti.

Në rastet e lartëpërmendura, klienti ka të drejtë:

Të ketë përparësinë e një pakete turistike alternative, pa kosto ekstra ose me kthimin e shumës në rast të shtese pageses nëse paketa e dytë turistikë është më e ulët se e para. Të marr për sipër vetëm shumën e parave tashme të dhëna. Rimbursimi duhet të bëhet brenda 7 ditë pune nga koha e marrjes së formularit të shkruar të aplikimit për rimbursim.

Klienti duhet të paraqesë vendimin e tij (pranon ndryshimin ose tërhiqet) brenda dhe jo me gjate se dy ditë pune nga momenti që i është dhënë njoftimi për ngritjen ose ndryshimin e çmimeve. Në mungesë te komunikimit te prerë, brenda kohës së lart përmendur, propozimi i formuluar nga organizuesi konsiderohet si i pranuar.

Anullimet nga Organizatori

Kjo pakete udhëtimi ka nje numer minimal pjesemarresish prej ..11 Persona.... Ne rast mosplotesimi te ketij numri Organizatori ka te drejte ta anulloje udhëtimin duke e lajmeruar Klientin te pakten10 dite perpara udhëtimit.

Organizatori mund ta anullojë udhëtimin edhe për shkak të një force madhore si: termete, stuhi, greva, etj.

Sigurimi i Shëndetit ne Udhëtim

Sigurimi ne udhëtim nuk është i përfshirë në çmim, por është e rekomanduar të bëhet Sigurim Shëndetësor

Transferimi i Rezervimit drejt nje personi tjetere

Kjo Kontrate..... Nuk Lejon..... oseE Lejon zevendesimin e Klientit me nje person tjetere

Kufizimet nga Përgjegjësia per Organizatorin e Udhëtimit.

Organizatori shkarkohet nga përgjegjësia për të kompensuar ndonjë dëm pasuror apo jopasuror që ka pësuar klienti në rastin kur anulon paketën e udhëtimit për shkak:

1. Të forcës madhore.

2. Organizatori nuk është përgjegjës në rast se mospërbushja e plotë ose e pjesshme e detyrimeve të tij rrjedhin për shkak të:

a- veprimeve të klientit;

b- veprimeve, të një pale të tretë, që nuk ka lidhje me ofrimin e shërbimeve të kontraktuara, të cilat janë të paparashikuara ose të pashmangshme ;

c- një rrethane të një force madhore ose një ngjarjeje, të cilën organizatori dhe/ose nënkontraktorët e tij, me gjithë kujdesin e duhur, nuk mund ta parashikojnë a ta parandalonin.

ANKESAT

Klienti ka të drejtë të ankohet tek organizatori, për çdo mospërbushje të kontratës, brenda afatit prej 7 ditësh nga përfundimi i udhëtimit. Organizatori detyrohet të shqyrtojë ankesën dhe të kthejë përgjigje brenda afatit prej 3 ditësh nga marrja dijeni për ankesën. Ankesat mund te dergohen ne adresen e emailit: mti@mtitravel.al

MTI TRAVEL



KLIENITI